

VENDIM
Nr. 640, datë 29.7.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 551, DATË 15.7.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI PAGË TË
PUNONJËSVE, OFICERË DHE NËNOFICERË, TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 5, të nenit 34, të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2003, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1 “Paga bazë sipas gradës për punonjësit, oficerë dhe nënoficerë, të Gardës së Republikës së Shqipërisë”, e përmendur në pikën 1, të vendimit nr. 551, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2021.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr. 1

**PAGA BAZË, SIPAS GRADËS PËR PUNONJËSIT OFICERË DHE NËNOFICERË TË
GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Roli i punonjësve sipas gradave		Grada	Paga bazë për gradë
1	2	3	4
Për punonjësit oficerë	madhor i lartë	Gjeneral garde	126500
		Kolonel	113400
		Nënkolonel	100400
		Major	86600
	i mesëm	Kapiten	74200
		Nënkapiten	70500
		Toger	67000
	i ulët	Nëntoger	64100
Për punonjësit nënoficerë	madhor i lartë	Kryekapter	55200
		Kapter	52500
		Kapter shtabi	51400
		Kapter mjeshtër	50300
	i mesëm	Kapter i parë	49900
		Kapter i dytë	49400
		Kapter i tretë	48900
	i ulët	Kapter i katërt	48000
		Rreshter	46700